

CERTIFIKATË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE PËR LLOGARI TË VET BRENDË VENDIT

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për marrjen e certifikatës për transportin e udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	Veprimtaria e transportit të udhëtarëve për llogari të vet brenda vendit, ushtrohet kundrejt certifikatës. Certifikata lëshohet për persona juridikë ose fizikë. Aplikanti, përveç dokumenteve të përgjithshme duhet të përcaktojë pikën e hipjes dhe të zbritjes së udhëtarëve në formularin e aplikimit.
<u>Baza ligjore:</u>	▪ Ligji Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ▪ Ligj Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”. ▪ Ligj Nr. 37/2014 për disa shtesa në ligjin Nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar. ▪ Ligj Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.” ▪ Udhëzim Nr. 15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar me Udhëzim Nr.5, datë 17.2.2011
<u>Përfituesi</u>	Bizneset, qytetarët.
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Zyra/Specialisti i transportit
<u>Afati</u>	15 ditë
<u>Tarifa</u>	Bazuar në paketën fiskale
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	▪ Formularin e auto deklaramit; ▪ Certifikata e regjistrimit në organin tatimor ose në QKB; ▪ Ose ekstrakti i regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB. ▪ Leja e qarkullimit, Certifikata e kontrollit teknik , Kontrata e sigurimit (për çdo automjet dhe pasagjerët); Leja e drejtimit; ▪ Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij); ▪ Vërtetim që janë likuiduar detyrimet vendore. *Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje të noterizuara.
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit. (outputs)</u>	Certifikatë
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Bashki Sporteli i shërbimit të taksapaguesve Sporteli në Njësinë Administrative